



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Data 20 / 02 / 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Gazoili”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi PCV 09134100-8 (Karburant diesel).

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fond limit : **2 712 858** *(dy milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë)*
lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Vërtetim për xhiron mesatare vjetore për tre vitet e fundit ushtrimorë duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të ketë një vlerë jo më të ulët se 30% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve dhe xhiros mesatare është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit

pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësisve vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2021 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore ” dhe në proporcion të drejtë me objektin e prokurimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit ushtrimore duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë (**me vetedeklarim**) se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 ore sipas kërkesave të autoritetit kontraktor .

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoj minimumi një pikë karburanti në një distancë tokësore jo më larg se 15 km nga Bashkia Kuçovë (vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose qeraje, të pasqyruara në ekstraktin e rregjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë bashkepunimi noteriale për gjithë kohëzgjatjen e kontratës), në përmbushje të nevojave të vazhdueshme dhe në mënyrë të leverdisshme për Autoritetin Kontraktor.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ky kriter është i nevojshëm dhe i arsyeshëm për autoritetin kontraktor, duke përmbushur nevojat e saj në mënyrë të leverdisshme për Bashkinë Kuçovë. Njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e këtij kriteri për operatorët ekonomik ofertues, se në rastin që nuk disponojnë një pikë karburanti në një distancë tokësore jo më larg se 15 km nga Bashkia Kuçovë, duke vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil.

2.3.4 Leje për tregtim të karburantit të lëshuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, duke garantuar në përfundim autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT